



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19 Prill 2023

Nr: 388

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 156, TË KOALICIONIT PËR
REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ PERSONIT
PËRGJEGJËS NË BASHKINË TROPOJË, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 19 Prrill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Zj. Klodiana Aliaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tropojë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës për shkelje administrative

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 dhe nenit 171 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Data: 19.04.2023

Nr: 388
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncime për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike, nga bashkia Tropojë, për të cilën pretendohet mosraportimi i veprimtarisë publike nga ana e personit përgjegjës për raportimin.

Denoncimi dhe indica është marrë nëpërmjet provës link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Në vijim të procedurës administrative, fillova hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike për të cilat ka indicje të besueshme se ka shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, si dhe të drejtën e tyre për t’u paraqitur në seancë publike.

Denoncuesi pretendon si më poshtë vijon:

Bashkia Tropojë, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me **nr. 156 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 156 ID**, i iniciuar nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) *“Emocion i veçantë për mua dhe stafin tim jo vetëm të marrim pjesë por dhe të nderojmë me mirënjohje drejtues e mësimit ndërmjet vite, në 100-vjetorin e shkollës “Jaho Salihu”, në Bujan në Krasniqë të Malsisë së Gjakovës. Jo vetëm Bujani, por e gjithë Tropoja është një trevë e shquar jo vetëm për historinë dhe kulturën e dëshmuar, por për etjen për arsim. Në të gjithë shërbimin tim publik kam qenë konsistent dhe do vijoj me përparësi të mbështes edukimin arsimor të rinisë së Tropojës, si një vlerë që garanton të ardhmen tonë. Suksese dhe mirënjohje për të gjithë mesuesit e nxënësit të një shekulli të Bujanit e Tropojës”*.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=643585481108325&set=pcb.643578404442366>

Më datë 13.3.2023 bashkisë Tropojë i është kërkuar informacion në lidhje me indicjet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Data: 19.04.2023

Nr: 388
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, njëkohësisht dhe për komunikimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nuk i është përgjigjur kërkesës tonë për informacion.

Në përfundim të hetimit administrativ, u provua se aktiviteti i mësipërm, referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaria e kryer në denoncimin e regjistruar me **nr. 156**, përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”*, **bashkia Tropojë ka pasur detyrimin për raportim** në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 3, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor *“raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)”*.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet se *“shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor...nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”*, pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstaton se zj. Klodiana Aliaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tropojë ka shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimet nr. 9, datë 9.3.2021, dhe nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Data: 19.04.2023

Nr: 388
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

VENDOS:

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për:
 - a) zj. Klodiana Aliaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tropojë, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Y.Merkaj _____

Data: 19.04.2023

Nr: 388
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”